

Nr. Prot

Tiranë, më _____.____. 2025

Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Njoftimi i shkurtuar i Kontratës

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa Rruga "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.
Tel/Faks +355 42 228 349, +355 42 239 295
E-mail info@kesh.al
Ueb-faqe www.kesh.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar – Shërbime – Mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik , ku të gjithë kushtet janë të përcaktuara.

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: Nr.REF-51592-06-18-2025

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Riparim, mirëmbajtje e automjeteve të KESH sh.a".

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Riparime, mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjete dhe pajisje të lidhura- 50100000-6.

6. Fondi limit: Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 41,700,150 (Dyzet e një milion e shtatëqind mijë e njëqind e pesëdhjetë) Lek pa TVSH ose 425,381.52 (katëqind e njëzetë e pesëmijë e treqind e tetëdhjetë e një pik pesëdhjetë e dy) Euro pa TVSH.

Shumatorja e çmimeve për njësi është : 232,138,230 (Dyqind e tridhjetë e dy milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH ose 2,368,032.54 (dy milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e tridhjetë e dy pik pesëdhjetë e katër Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 18/06/2025 është 98.03Lekë/Euro.

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 (dymbëdhjetë) muaj, nga hyrja në fuqi e marrëveshjes kuadër.

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 10 /07/2025 ora 10.00.

Në zbatim të nenin 42, pika 6, të LPP, i ndryshuar ku citohet se:

Përfundimisht, për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor argumenton se për shkak të një gjendje urgjence e ka të pamundur respektimin e afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, afati i pranimit të ofertave mund të shkurtohet deri në

15 ditë nga data në të cilën është publikuar njoftimi i kontratës. Në çdo rast, argumentimi mbi arsyet e shkurtimit të këtij afati do të jepet nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e kontratës, argumentojme se:

Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të AK, kategorizohet tek shpenzimet operative të domosdoshme, pasi lidhet me mbarëvajtjen e punës së kompanisë dhe sigurinë e shëndetit dhe jetës së punonjësve të cilët udhëtojnë me këto mjete që kanë nevojë për riparim.

Referuar situatës aktuale, si dhe mbarimit të zbatimit të kontratës së mëparshme dhe nevojës emergjente për riparime paraqitet e nevojshme që procedura e kërkuar të realizohet në një afat më të shkurtër (se ajo standarte 35 ditë në këto raste), pra të realizohet për 22 ditë, e vlefshme, kërkuar dhe propozuar kjo nga AK duke patur parasysh se automjetet e KESH sh.a dhe Njësive të Prodhimit Hec Fierzë, Hec Koman dhe Hec Vau i Dejës kërkojnë riparime emergjente, ku edhe nga ecuria e zbatimit të kontratës riparimi i tyre është konsideruar dhe konsiderohet domosdoshmëri. Pra jemi në një rast, ku nevoja për shërbime emergjente riparimi nuk do mund të mbulohej menjëherë.

Argumentuar sa më sipër, AK vendos shkurtimin e afatit për pranimin e ofertave nga 35 ditë në 22 ditë.

9. Procedurë e Rishpallur:

Po**Jo****X**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erald Elezi